


BULETINI



SHTATOR 2024

Buletini i ACDC-së i këtij muaji përmbanë përditësime kryesore, duke përfshirë nisjen e iniciativave të fokusuara në drejtësinë mjedisore dhe të drejtat e njeriut, si dhe kampet e ardhshme rinore. Ne, gjithashtu kemi filluar një fushatë derë më derë për ndërgjegjësimin e të drejtave pronësore dhe vazhdojmë të ofrojmë shërbime falas të ndihmës juridike në Mitrovicën e Veriut.

KONTRATA E NËNSHKRUAR ME PËRKTHYES DHE BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL NË MITROVICË

Më 3 shtator, Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, nënshkroi vazhdimin e kontratës me 3 përkthyes dhe 3 bashkëpunëtorë profesional në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Në nënshkrim morën pjesë Bekim Veliqi, ushtrues detyre i kryetarit të Gjykatës dhe Andrea Lako, shëf i drejtësisë në UNMIK. Kjo është realizuar në kuadër të projektit të financuar nga UNMIK-u, "Mbështetja e Qasjes në Drejtësi në Kosovën Veriore", projekt që synon të rrisë efikasitetin gjyqësor dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve të pazgjidhura përmes përkthimit dhe shërbimeve profesionale.



Në shtator, ACDC publikoi thirrjen duke ftuar të rinjtë e moshës 13-18 vjeç nga komunitete të ndryshme etnike në Kosovë për të marrë pjesë në një seri kampesh rinore në kuadër të projektit Youth Empowered through Inclusive Schools and Societies (YESS), financuar nga Fondi i Përgjithshëm për Ndërtimin e Paqes të Sekretarit të OKB-së dhe zbatuar nga IOM. Kampi i parë do të mbahet nga 4-6 tetor 2024, në Pejë, me kampe shtesë të planifikuara nëpër vende të ndryshme në Kosovë.



ACDC ka dy projekte të reja duke filluar nga ky muaj:

EcoUnity: Fuqizimi i Grave dhe të Rinjve për Drejtësi Mjedisore në veri të Kosovës



Kjo iniciativë, e zbatuar nga ACDC dhe Education Code, synon të fuqizojë gratë dhe të rinjtë nga komunitetet multietnike që të avokojnë për drejtësi mjedisore. I mbështetur nga UNDP dhe i financuar nga Luksemburgu, Republika e Koresë, Norvegjia dhe Suedia, projekti do të nxisë udhëheqësit përmes seminareve edukative, takimeve avokuese dhe bashkëpunimit me SME-të për të promovuar praktikën e qëndrueshme dhe të drejtat mjedisore.

Në kuadër të projektit EcoUnity, u mbajtën takime avokuese në Mitrovicën e Veriut dhe Zubin Potok, duke trajtuar çështjet kyçe të drejtësisë mjedisore, siç janë sfidat lokale, zgjidhjet e mundshme dhe mundësitë për bashkëpunim ndërmjet komuniteteve.



Avancimi i të drejtave të njeriut përmes aktiviteteve në terren

I mbështetur nga UNMIK-u, ky projekt fokusohet në përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe forcimin e efikasitetit, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të ofruara nga institucionet gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit në Kosovë. Projekti, gjithashtu synon të mbyllë boshllëqet në zbatimin e të drejtave të njeriut duke mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës (IAPK) në angazhimin e tij me shoqërinë civile dhe komunitetet.

Në periudhën e ardhshme, ACDC do të bashkëpunojë me Avokatin e Popullit, për të lehtësuar një sërë takimesh në mbarë Kosovën duke adresuar çështjet kyçe të komunitetit.

ACDC NIS FUSHATËN DERË MË DERË PËR NDËRGJEGJËSIM TË TË DREJTAVE PRONËSORE NË VERI TË KOSOVËS

Në shtator, OJQ ACDC ka nisur një fushatë derë më derë që synon përmirësimin e ndërgjegjësimit për procedurat e regjistrimit të pronës, disponueshmërinë e ndihmës juridike, incentivat tatimore dhe përfitimet përkatëse. Gjatë katër muajve të ardhshëm, ekipe të dedikuara do të vizitojnë familjet nëpër komuna dhe fshatra për të shpërndarë materiale informuese dhe për të ofruar udhëzime për të drejtat pronësore.

SHËRBIMET PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

OJQ ACDC vazhdon të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas në zyrën tonë të vendosur në adresën: Çika Jovina 3, Mitrovica Veriore. Ftojme të gjithë ata që përballen me sfida në ushtrimin e të drejtave të tyre në Kosovë të na vizitojnë për ndihmë. Bashkëpunëtorët tanë juridikë do të ofrojnë shërbime ligjore, informata dhe këshilla falas, veçanërisht për grupet vulnerabël.

ACDC PUBLIKON ARTIKUJ MBI MONITORIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

OJQ ACDC ka publikuar katër artikuj në kuadër të projektit "Lehtësimi i bashkëpunimit ndëretnik përmes monitorimit dhe raportimit të rasteve të krimeve të luftës". E udhëhequr nga Internews Kosova në partneritet me ACDC, kjo nismë synon të kontribuojë në drejtësinë tranzicionale duke dokumentuar seancat gjyqësore të krimeve të luftës në Kosovë dhe duke rritur ndërgjegjësimin si tek institucionet gjyqësore ashtu edhe tek publiku i gjerë.



Ky projekt mbështetet nga Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR KS), financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

PROMOVIMI I NDËRGJEGJËSIMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Në përkushtimin tonë të vazhdueshëm për të avokuar për të drejtat e njeriut, OJQ ACDC publikoi një postim duke theksuar të drejtat e parashikuara në Kushtetutën e Kosovës. Ky publikim synon të informojë qytetarët për të drejtën e tyre për të mbrojtur të drejtat e tyre nëpërmjet sistemit gjyqësor dhe nënvizon përgjegjësinë e institucioneve për të ruajtur dinjitetin, edhe gjatë procesit penal. Kjo nismë është në kuadër të projektit #HumanRightivism, i zbatuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) me mbështetjen e Ambasadës Suedeze në Prishtinë.



DEKLARATË PËR MEDIE: KOALICIONI DEMOKRACIA NË VEPRIM I KËRKON KQZ-SË PËRGATITJET PËR ZGJEDHJE

Në bashkëpunim me koalicionin Demokracia në Veprim (DnV), ACDC nënshkroi një deklaratë për medie duke i kërkuar KQZ-së të sigurojë përgatitje të plotë për proces të qetë votimi në misionet diplomatike të Kosovës. Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 do të prezantojnë opsione të reja votimi, si personalisht dhe me postë në 35 përfaqësi diplomatike për qytetarët jashtë vendit.



SRB



ENG



ALB

TAKIMET KRYESORE

Më 12 shtator, Dushan Radaković u takua me ambasadorin e BE-së Aivo Orav gjatë vizitës së tij në veri të Kosovës, së bashku me përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile dhe komunitetit serb të Kosovës.



Përveç kësaj, më 17 shtator, drejtori i programit të OJQ ACDC, Aleksandar Rapajić, u takua me Përfaqësuesen Speciale të UNMIK-ut, Caroline Ziadeh, në Mitrovicë për të diskutuar zhvillimet e fundit politike, të sigurisë dhe ekonomike me shoqërinë civile, akterët politikë dhe liderët e komunitetit.



ACDC në MEDIA

Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC, së fundi foli në RTS për sfidat në rritje me të cilat përballet komuniteti serb në veri të Kosovës.



Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i ACDC, për Media Center Cagllavica



Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i ACDC, për RTS



Ines Aljović Mihajlović, Zyrtare e Programit në OJQ ACDC, u shfaq në emisionin e mëngjesit në RTK2, ku ndau më shumë detaje rreth kampeve të ardhshme dhe inkurajoi të rinjtë të aplikojnë.

